



Prishtinë, 30 nëntor 2012  
Kodi i ZRRE-së: V\_488\_2012

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 03/L-185);
- Nenin 16 paragrafi 3 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit, me Nr. 402/12 të datës 15 qershor 2012 i nxjerrë nga Bordi i ZRRE-së;
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, për njësinë Lumëbardhi II. me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, në Komunën e Deçanit, të datë 09.11.2011 të ndërmarrjes “Kelkos-Energy” sh.p.k., me adresë rruga “Zagrebit” nr. 19/22, Prishtina, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 30 nëntor 2012 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_296\_2010 i datës 11 nëntor 2010 (me kohëzgjatje dy vjeçare), edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht **deri me 11 maj 2013.**

## A r s y e t i m

- ZRRE me datë 09.08.2010 nga ndërmarrja “Kelkos-Energy” sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, me kapacitet të instaluar prej 23.1 MW, në lokacionet: “Lumëbardhi II.” me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, “Belaja” me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW dhe “Deçan” me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW, të gjitha në Komunën e Deçanit.
- Me datë 11 nëntor 2010 Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmimeve të prezantuara nga ndërmarrja “Kelkos-Energy” sh.p.k., ka vendosur se ky aplikacion ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja



gjeneruese nga Uji, dhe ka lëshuar Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_296\_2010.

- Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
  - Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (2) dy vjeçar, dhe në këtë vendim përcaktohet se ndërmarrjes “Kelkos-Energy” sh.p.k., do t’i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
  - Me datë 29.02.2012 ZRRE nga ndërmarrja “Kelkos-Energy” sh.p.k., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për njësitë gjeneruese: HC “Belaja” dhe HC “Deçan”.
  - Me datë 15.06.2012 Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me vendimin V\_402\_2012 ka vendosur që ndërmarrjes “Kelkos-Energy” sh.p.k., ti lëshohet Autorizimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, me kapacitet të instaluar prej 17.6 MW, që përbëhet prej dy (2) njësive gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: HC “Belaja” me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW dhe HC “Deçan” me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW, në Komunën e Deçanit. Ndërsa për njësinë “Lumëbardhi II” me kapacitet prej 5.5 MW që është pjesë e aplikacionit, do të shqyrtohet dhe vendoset pas sjelljes së Lejes Ujore dhe Lejes së Ndërtimit.
  - Me datë 09.11.2012 ZRRE nga ndërmarrja “Kelkos-Energy” sh.p.k., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_296\_2010 të datës 11 nëntor 2010, për njësinë gjeneruese HC “Lumëbardhi II” me kapacitet prej 5.5 MW edhe për tre (3) muaj, deri me 11 shkurt 2013.
  - Ndërmarrja “Kelkos-Energy” sh.p.k., në kërkesën e saj ka sqaruar se nga Departamenti i Ujërave i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në datën kur është vendosur për lëshimin e Lejes Ujore për HC “Belaja” dhe HC “Deçan”, për HC “Lumëbardhi II” nevojitet prova shtesë, dhe është kërkuar që të bëhet një studim sipas standardeve teknike ndërkombëtare lidhur me skenarët e mundshëm teorik të katastrofës në rast të dështimit kaskadës. Ky studim do të dorëzohet pranë këtij departamenti për shqyrtim.
  - ZRRE pas analizimit të kërkesës për shlyerje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, për njësinë gjeneruese HC “Lumëbardhi II” ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Ndërmarrja “Kelkos-Energy” sh.p.k., duhet të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim, për njësinë gjeneruese HC “Lumëbardhi II” deri me datë 11 maj 2013 duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi. Pas



kësaj date Vendimi V\_296\_2010 i datës 11 nëntor 2010 mbi Njoftimi për Autorizimin Preliminar, për njësinë gjeneruese HC “Lumëbardhi II” do të shfuqizohet.

- III. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar